

AKT THEMELIMI

Për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “BALCANICA GROUP” Sh.p.k.

Sot, më datë 3 Tetor të vitit 2023 (*dy mijë e njëzet e tre*) ortakët:

Bledjan ÇOLLAKU biri i Fevriut, i datëlindjes 24.08.1982, lindur dhe banues në L. “ 29 Nëntori”- Vlorë, me K. Identiteti Nr.I208240780,

Riccardo ALLEGRINI biri i Grazianos, i datëlindjes 16.06.1981, lindur në Brescia dhe banues në Via:”Consortille Cattarello” Nr. 2/F Chiari-Brescia, me K. Identiteti Nr. CAJ53326Q,

Flavio VIDA biri i Dantes, i datëlindjes 06.01.1982, lindur në Montichiari-Brescia dhe banues në Via:”Scaletta” Nr. 16 Monigo Del Garda-Brescia, me Pasaportë Nr. YA6759828,

Fabio BOTTI biri i Renatos, i datëlindjes 03.01.1979, lindur në Calcinate-Bolonjë në Vi:”Della Liberta” Nr. 92 Covo-Bergamo, me Pasaportë Nr. YB2788395,

Vendosën të themelojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar si më poshtë vijon:

Neni 1

Personat fizikë të sipërpërmendur, me vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë në pajtim me legjislacionin shqiptar krijojnë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k.) me emërtimin “BALCANICA GROUP” Sh.p.k.

Ortakët e kësaj shoqërie janë:

Bledian ÇOLLAKU, Riccardo ALLEGRINI, Flavio VIDA dhe Fabio BOTTI
Administrator i shoqërisë është z. Bledian ÇOLLAKU.

Shoqëria ka të drejtë të krijojë filiale të saj brenda dhe jashtë vendit në çdo kohë që do të çmohet e aresyeshme prej saj me aprovimin e organeve kompetente.


Neni 2

Shoqëria “BALCANICA GROUP” Sh.p.k. gezon statusin e personit juridik. Veprimtaria e saj do të zhvillohet sipas dispozitave të kësaj kontrate, statusit të saj dhe legjislacionit në fuqi. Qendra e saj është në Vlorë, të rrethit Vlorë.

Statuti i shoqërisë bashkëlidhet me aktin themelimi dhe është pjesë përbërëse e saj.

Shoqëria ka vullnetin me përmbajtjen : Shoqëria “BALCANICA GROUP” Sh.p.k..

Neni 3



Veprimtaria e saj si person juridik fillon me aprovimin e krijimit të saj nga organet kompetente të shtetit dhe do të vazhdojë për një periudhë kohore mbi 10 vjet.

Neni 4

Shoqëria "BALCANICA GROUP" Sh.p.k. do të ketë si objekt:

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm :

- Veprimtari në tregun imobiliar, agjensi imobiliare.
- Aktivitet në fushën e ndërtimit, si objekte, rrugë, kanalizime, vepra arti(Ura), Ujësjellësa etj.
- shfrytëzim i gjithë produkteve dhe nënprodukteve të materialeve të ndërtimit,
- eksport dhe import me shumicë dhe pakicë të tyre,
- shitje-blerje makinerish pune të përpunimit të materialeve të ndërtimit dhe nënprodukteve të tyre,
- aktivitet transporti kombëtar dhe ndërkombëtar mallrash, makineri, pajisje dhe lënde të para.
- Prodhim dhe tregtim i inerteve, parafabrikateve dhe granileve, ndërtim i objekteve të ndryshëm industriale e civile, rrugë, kanalizime, ujësjellës, rikonstruksione, riparime të ndryshme etj.
- Me zgjerimin e aktivitetit, shoqëria "BALCANICA GROUP" Sh. p. k. , ka të drejtë të bëjë shtesa në objekt, ose edhe ndryshime të objektit të veprimtarisë së saj, duke kryer respektivisht ndryshimet përkatëse në Statut.

Neni 5

Kapitali themeltar i kësaj shoqërie është 100.000 (njëqint mijë) Lekë. Ortakët marrin pjesë në të si më poshtë:

- Bledian ÇOLLAKU, kontribuon në shumën 30.000 (tridhjetë mijë) Lekë, pra 1 (një) kuotë në raportin 30%,
- Riccardo ALLEGRINI, kontribuon në shumën 30.000 (tridhjetë mijë) Lekë, pra 1 (një) kuotë në raportin 30%,
- Flavio VIDA, kontribuon në shumën 30.000 (tridhjetë mijë) Lekë, pra 1 (një) kuotë në raportin 30%, dhe
- Fabio BOTTI, kontribuon në shumën 10.000 (dhjetë mijë) Lekë, pra 1 (një) kuotë në raportin 10%.

Neni 6

Fitimi NETO që do të realizohet nga veprimtaria e kësaj shoqërie do të ndahet në bazë të kuotave që zotëron secili prej ortakëve në shoqëri.

Neni 7

Për detyrimet që do të krijohen ndaj personave të tretë të kësaj shoqërie, ajo do të përgjigjet vetëm me kapitalin e saj.

Neni 8




Marrëdhëniet e punës ose në filialet e saj rregullohen nëpërmjet kontratës së punës.

Neni 9

Dispozita të hollësishme mbi organizimin e kësaj shoqërie përcaktohen në statutin e saj. Themeluesit e shoqërisë si e lexuan me vëmendje aktin e themelimit të mësipërm dhe e gjetën konform vullnetit të tyre e firmosin pa vërejtje.

ORTAKËT e SHOQËRISË

Bledian ÇOLLAKU



Riccardo ALLEGRINI



Flavio VIDA



Fabio BOTTI

